

VENDIM
Nr. 114, datë 16.3.2000

PËR PROKURIM TË DREJTPËRDREJTË TË FONDEVE PËR AUDITIMIN E SHOQËRISË
ANONIME “AMC”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Autorizohet shoqëria anonime “AMC” të prokurojë, me procedurën e prokurimit të drejtpërdrejtë, fondin prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, me shoqërinë Deloitte & Touche, për auditimin e kompanisë (revizionimin e llogarive të vitit 1999), në kuadër të privatizimit të saj.

2. Ky fond të përballohet nga shoqëria anonime “AMC”.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqëria anonime “AMC” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta